



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:163035

Datë: 29.12.2022

Numri i dokumentit: 03811216

C.nr.296/22

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Hatixhe Begaj në çështjen juridike të paditësit A. (A.) M. nga fshati Ll., Komuna e M., të cilin e përfaqëson av. Nuhi Krasniqi nga Malisheva, kundër të paditurës K.N.T. "D. C." Sh.P.K me seli në P., të cilën e përfaqëson Drejtori i Përgjithshëm D. N., me adresë Rr. "B. K." nr. ... P., sipas bazës juridike, vërtetim i pronësisë- pjesë e ndërtesës, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.12.2022 merr këtë:

**A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

- I. Aprovohet** në tërësi si e bazuar padia e paditësit A. (A.) M. nga fshati Ll., Komuna e M..
- II. Vërtetohet** se paditësi A. (A.) M. nga fshati L., Komuna e M. me numër personal ..., është pronar i pronës me numër të njësisë kadastrale në sipërfaqe prej 71 m² banesë, kati IV-të, në vendin e quajtur "M.e H." Z. Kadastrale në M. e të cilën pronë e ka blerë nga e paditura K.N.T. "D. C." me seli në P..
- III. Detyrohet** i padituri që paditësit t'ia lejoj regjistrimin e të drejtës së pronësisë në regjistrin Kadastral në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Komuna e M..
- IV. Obligohet** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në M. që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, paluajtshmëritë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi t'i regjistrojë në librat kadastral në emër të paditësit A. M. nga fshati L., Komuna e M..
- V. Secila palë** i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi A. M. nga fshati Ll., Komuna e M., të cilin e përfaqëson av. Nuhi Krasniqi nga Malisheva, me datën 12.05.2022, në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë ka parashtruar padi kundër të paditurës K.N.T. “D.C.” Sh.P.K me seli në P., sipas bazës juridike, vërtetim i pronësisë- pjesë e ndërtesës, në bazë të pohimit. Sipas padisë, paditësi me datë 04.11.2013 nga e paditura ka ble banesën- pjesën e ndërtesës me numër në sipërfaqe prej 71 m2 në vendin e quajtur “M. e H.” ZK në M., tash e evidentuar në emër të të paditurës sipas certifikatës me nr. të lëndës të datës 11.05.2022. Fillimisht kjo pronë ka qenë e evidentuar në emër të Komunës së M. dhe blerësi i saj (këtu paditësi) përkundër asaj që e ka paguar çmimin e pagesës në shumën prej 30,000.00€ nuk ka mundur të bëjë përkthimin e saj kurse pasi prona është bartur në emër të K.N.T. “D. C.” Sh.P.K me seli në P. për shkak të neglizhencës ajo ka mbetur pa u bartur tek blerësi i saj. Duke kërkuar kështu që me anë të aktgjykimit- në bazë të pohimit ta aprovoj në tërësi padinë edhe kërkesë padinë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi të parashtruar me datë 22.11.2022 ndër të tjera ka deklaruar se në bazë të kërkesës sipas aktvendimit nr. 2022:163035 së gjykatës themelore Gjakovë dega në M., D. C. Sh.P.K në P. ju informon se Z. A. M., me nr. personal ... në cilësinë e blerësit të banesës së objektin banesor lagjja H., nr. ... (njësia nr. ... në sip.71 m² kati i katërt, hyrja e parë, dëshmojmë se i ka përmbushur të gjitha detyrimet si blerës ndaj D.C., Sh.p.k. Prishtinë në cilësinë e shitësit të pronës, andaj pajtojmë me Aktvendimin e Gjykatës për regjistrimin e pronës në shërbimin kadastral të Komunës së Malishevës.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi më sa vijon: nga certifikata e pronës, me nr. ... të lëshuar me datë 11.05.2022 nga Zyra Kadastrale Komunale në M., u konstatua fakti se njësi kadastrale ..., pjesë e ndërtesës me sipërfaqe prej 71 m², në vendin e quajtur “M. e H.” në Malishevë, evidentohet me nga 1/1 në emër të paditurës K.N.T. “D. C.” Sh.p.k, me seli në P.. Ndërsa nga kontrata jo formale e shitblerjes e lidhur me datë 04.11.2013 në mes të blerësit A. M. dhe shitësit K.N.T. “D. C.” Sh.p.k, me seli në P., rezultoi se palët janë pajtuar lidhur me shitblerjen e kësaj njësie banesore, ashtu që blerësi ta paguaj shumën prej 30,000€, mirëpo palët janë pajtuar që këtë shumë blerësi ta kompensoj me kryerjen e punëve- zeytare (instalimi i rrjetit elektrik) në objektet që i ndërton K.N.T. “D.C.” Sh.p.k, me seli në P..

Meqenëse nga parashtresa e padisë u konstatua se paditësi në vitin 2013 e kishte blerë nga e paditura këtë njësi banesore të përcaktuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përkatësisht palët në mes vete ishin pajtuar që për çmimin e shitjes së këtij objekti të kompensohet me kryerjen e punëve ndërtimore- zeytare (instalimi i rrjetit elektrik), njëkohësisht duke u bazuar edhe në faktin se e paditura me anë të përgjigjes në padi nuk e kontestoi faktin se paditësi e ka blerë dhe e ka përmbushur detyrimin ndaj saj, gjykata mbi bazën e deklarimeve të paditësit dhe deklarimeve të të paditurës në përgjigjen në padi, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, andaj meqenëse në mes palëve ndërëgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u

vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata bazuar në dispozitat e nenit 152 dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 57.1 të ligjit për pronësinë dhe drejtat sendore vendosi t'ia aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Gjykata po ashtu me rastin e vendosjes nuk gjeti rrethana me të cilat do të konstatohet se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht sipas nenit 3 paragraf.3 të LPK-së, andaj bazuar edhe në të lartcekurat vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe për këtë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.296/2022 me datën 29.12.2022**

**G j y q t a r i
Nehat Qelaj**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.